

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

9.03.2023  
Ora, 10:13

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Socialiste e Shqipërisë” për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:      **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja, P. Doçaj**
- **Parti Politike:**      **PDSH, Bindja Demokratike, Partia e Lirisë, Lëvizja Bashkë, LZHK**
- **OJQ:**      **KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Mirëmëngjesi të gjithëve! Në seancën e sotme publike kemi në rend të ditës kërkesat për regjistrimin e disa partive politike si subjekt zgjedhor, kemi kërkesën e Partisë Socialiste, kërkesën e Partisë së Lirisë, Partisë Demokratike, Bindje Demokratike, Lëvizje për Zhvillim Kombëtar, Partisë “Lëvizja bashkë”. Gjithashtu, kemi edhe projektvendimin “Për një shtesë në vendimin nr. 79, datë 1.3.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për akreditimin e vëzhguesve afatgjatë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet

**Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. Këto çështje kemi. Nuk kemi çështje të tjera?

**Z. Y. Merkaj:** Jo, nuk kemi çështje të tjera.

**Z. I. Celibashi:** Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

**Z. Y. Merkaj:** Faleminderit, zoti Kryetar! Partia Socialiste e Shqipërisë nëpërmjet kërkesës së nënshkruar nga kryetari i saj ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për regjistrim si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Kërkesa e paraqitur nga Partia Socialiste respekton afatin kohor të parashikuar në nenin 64, pika1, të Kodit Zgjedhor dhe pas verifikimit të dokumentacionit konstatohet se është në përputhje me nenin 64, pika 2, të Kodit Zgjedhor. Për këto arsye i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve regjistrimin e Partisë Socialiste si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Ndonjë diskutim nga përfaqësuesit e partive politike nuk kemi në lidhje me këtë çështje, atëherë miratohet kërkesa e Partisë Socialiste të Shqipërisë për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

**Vendimi nr. 153**

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

9.03.2023  
Ora, 10:15

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia e Lirisë”  
për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore  
të datës 14 maj 2023”.**

**PJESËMARRJA:**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:      **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja, P. Doçaj**
- **Parti Politike:**      **PDSH, Bindja Demokratike, Partia e Lirisë, Lëvizja Bashkë, LZHK**
- **OJQ:**      **KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me shqyrtimin e kërkesës së Partisë së Lirisë.

**Z. Y. Merkaj:** Partia e Lirisë nëpërmjet kryetarit të saj, zotit Ilir Meta, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për regjistrimin si subjekt zgjedhor të kësaj partie për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Kërkesa e paraqitur nga Partia e Lirisë respekton afatin kohor të parashikuar në nenin 64, pika 1, të Kodit Zgjedhor dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit konstatohet se është në përputhje me nenin 64, pika 2, të Kodit

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

Zgjedhor. Për këto arsye i propozohet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve regjistrimi i partisë politike Partia e Lirisë si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, miratohet edhe kërkesa e Partisë së Lirisë për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

**Vendimi nr. 154**

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

9.03.2023  
Ora 10:16

**RENDI I DITËS**

*Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Demokratike e Shqipërisë” për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.*


**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:      **Z. Y. Merkaj, Znj:M. Koja, P. Doçaj**
- **Parti Politike:**      **PDSH, Bindja Demokratike, Partia e Lirisë, Lëvizja Bashkë, LZHK**
- **OJQ:**      **KRIIK, Përfaqësues nga Shoqëria Civile**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër.

**Z. Y. Merkaj:** Regjistrimi i Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor. Janë paraqitur dy kërkesa: një kërkesë e nënshkruar nga zoti Sali Berisha dhe dokumentacioni përkatës, të cilit i mungon vërtetimi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, si dhe kërkesa tjetër është nënshkruar në emër të zotit Lulzim Basha, e nënshkruar nga i autorizuari me prokurë, zoti Indrit Sefa. Këto dy kërkesa dhe dokumentacioni përkatës ngelet në vlerësimin tuaj për t’u shqyrtuar në fund. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

**Z. I. Celibashi:** Meqenëse shoh që janë ulur edhe në vendet e tyre përkatëse përfaqësuesit e zotit Sali Berisha si kërkues për regjistrimin e Partisë Demokratike dhe të zotit Lulzim Basha për regjistrimin e Partisë Demokratike.

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PD:** Përfaqësues i Partisë Demokratike, dokumentacioni është i rregullt, i qartë, është marrë vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nga regjistri i partive politike dhe ku unë jam si përfaqësues i Partisë Demokratike.

**Z. I. Celibashi:** Që të mos kemi asnjë lloj keqkuptimi nga çdo pikëpamje, ne jemi para shqyrtimit të kërkesës për regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor. Përpara Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka dy kërkesa: një kërkesë vjen nga zoti Sali Berisha, i cili thotë jam kryetar i Partisë Demokratike dhe kërkon regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor. Kemi edhe një kërkesë tjetër nga zoti Lulzim Basha nëpërmjet përfaqësuesit të tij, që jeni ju, ku kërkohet regjistrimi i Partisë Demokratike. Pra, ne jemi në procesin e shqyrtimit të kërkesës për të regjistruar Partinë Demokratike si subjekt zgjedhor. Në këtë shqyrtim do të vlerësojmë se kush e ka edhe tagrin për ta paraqitur këtë kërkesë, është tagër i zotit Sali Berisha, si kryetar i Partisë Demokratike, nëse është kështu, apo tagër i zotit Lulzim Basha si kryetar i Partisë Demokratike, nëse është kështu. Pra, nuk është se jemi duke vendosur në këtë moment absolutisht asgjë. Është e natyrshme që nga pikëpamja procedurale të dëgjojmë këdo që bën kërkesën për të regjistruar një parti politike si subjekt zgjedhor. Në vlerësim të kësaj dëgjese do të themi se kush është ai që ka tagrin për ta paraqitur këtë kërkesë, kështu që mendoj qoftë edhe nga pikëpamja formale korrekte, por edhe nga pikëpamja përmbajtësore nga ajo çfarë arsyetova. Ndaj unë po jua jap fjalën juve dhe përfaqësuesit tjetër, i cili edhe ai pretendon që përfaqëson Partinë Demokratike. Nuk e ndajmë dot këtë gjë në mënyrë

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*


paraprake, sepse do të duhet ta konsiderojmë sikur e paragjykojmë këtë dhe kjo nuk ka asnjë agjendë tjetër përveçse bazueshmërisë në ligj.

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PD:** Siç është në dijëni edhe Komisioneri, edhe KQZ-ja, për çdo vendimmarrje i dërgohet përfaqësuesit të partisë politike projektvendimi paraprak. Në këtë rast nuk kemi një projektvendim nga ana e Komisionerit, i cili para se të dalë në seancë publike shqyrton të gjithë dokumentacionin ligjor dhe bën një projektvendim, i cili u komunikohet përfaqësuesve të palëve në proces pasi është bërë edhe verifikimi paraprak i dokumentacionit ligjor dhe dokumenteve të kërkuara. Meqë Komisioneri mendon që ta bëjë debat publik, ne jemi të gatshëm kurdo, nuk e kemi problem këtë pjesë.

**Z. I. Celibashi:** Nuk dua të bëj debat publik, sepse nuk është fare çështje e Komisionerit. Kjo është një çështje tërësisht e atyre që kanë paraqitur kërkesën për të regjistruar një parti politike si subjekt zgjedhor. Është shumë e thjeshtë kjo. Unë nuk mund të them paraprakisht pa e shqyrtuar këtë çështje se kujt i takon e drejta për ta paraqitur këtë kërkesë. Mund të ishte edhe një i tretë sot, i cili do të kërkonte regjistrimin e Partisë Demokratike me pretendimin që e ka ai tagrin për ta paraqitur këtë kërkesë..., është shumë e thjeshtë mendoj unë.

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD:** Po vazhdojmë ne, meqenëse kemi bërë kërkesën për regjistrim një ditë përpara se palët e tjera. Ledio Nuraj, përfaqësues i Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe zoti Franci Nuri përfaqësuesi i Partisë Demokratike të Shqipërisë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Këtu jemi në bazë të kërkesës që është paraqitur në datën 5 mars nga Partia Demokratike me të gjitha ekstremitetet dhe normat nistore Partia Demokratike e Shqipërisë, e dorëzuar nga kryetari i saj,

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

Doktor Profesor Sali Berisha, i cili, përveçse ka kërkuar regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor, na ka mandatuar edhe ne të dy si përfaqësues të kësaj force politike pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ftesa është sa për legjitimitetin tonë.

I nderuar zoti kryetar, ne kemi depozituar përpara jush kërkesën për regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor në zgjedhjet lokale të datës 14 maj 2023, ku bashkëlidhur kemi depozituar të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas Kodit Zgjedhor. Kemi depozituar kërkesën sipas kërkesave solemne dhe të gjitha kritereve që parashikon Kodi Zgjedhor. Ndër të tjera doja të citoja përpara jush, meqenëse kjo është një seancë publike e hapur, një debat i hapur, duke parë edhe situatën e krijuar, se Partia Demokratike e Shqipërisë është krijuar me urdhrin nr. 12 të datës 19.12.1990 të ministrit të Drejtësisë, ku pranë kësaj ministrie janë depozituar të gjitha aktet e themelimit të kësaj partie dhe ka vijueshmëri 32 vjeçare. Regjistrimet e fundit të këtij subjekti në regjistrin e partive politike datojnë ato të pas kuvendit të Partisë Demokratike të datës 29 prill të vitit 2018, ku këto regjistrime përfshijnë pasqyrimin në regjistër të organeve drejtuese të Partisë Demokratike, si: Këshilli Kombëtar, kryetari i Partisë Demokratike, Sekretari i Përgjithshëm dhe sekretariatet. Këto janë regjistrimet e fundit në fuqi të Partisë Demokratike. Gjithashtu, të regjistrueshme aktualisht janë, por që nuk janë pasqyruar në regjistrin e partive politike pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, janë vendimet e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike, të cilat janë mbajtur në datën 17 korrik 2021 dhe organet drejtuese të dala nga ky kuvend me përjashtim të kryetarit të Partisë Demokratike. Zgjedhja e të cilit aktualisht është ankimuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga kandidatja garuese në atë periudhë kur kandidoi kryetari i atëhershëm, zoti Lulzim Basha dhe ka një proces gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me numër çështjeje 6288, 30.6.2021, aktualisht në proces gjykimi,

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

i cili nuk është se ka marrë ende vendim, kështu që edhe pjesa e kryetarit ka mbetur e paregjistrueshme për shkak të këtij procesi gjykimi të atëhershëm. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës në datën 16.12.2021 është depozituar kërkesa e palës kërkuese Partia Demokratike, e përfaqësuar nga Komisioni i Rithemelimit konform ligjit për partitë politike. Objekt i kësaj kërkesë, që është depozituar pranë Gjykatës së Tiranës, për t'u regjistruar në regjistrin e partive politike, pikërisht në regjistrin e Partisë Demokratike, të administruar nga Gjykata e Tiranës, ka qenë depozitimi i ndryshimeve statutores sipas vendimeve të kuvendit të Partisë Demokratike, i mbajtur në datën 11 dhjetor 2021. Një kuvend, i cili është pasqyruar nga të gjitha mediet dhe të gjithë e dimë atë kuvend, që është thirrur në bazë të statutit të Partisë Demokratike, që ka qenë në fuqi, ku është vetëthirrur nga 1/4 e anëtarësisë së Partisë Demokratike, ashtu siç ishte e parashikuar në statut dhe ka qenë i rregullt konform ligjit. Në vendimin nr. 3 të datës 25.3.2022 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesës së palës kërkuese Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Komisioni i Rithemelimit dhe depozitimin dhe regjistrimin e vendimeve të kuvendit të datës 11 dhjetor 2021 në regjistrin e partive politike, pikërisht në regjistrin e partisë politike Partia Demokratike. Vendimet të cilat unë i citoj, ju i keni bashkëlidhur në kërkesën tonë të ardhur pranë jush për regjistrimin e kësaj force politike, ku ka qenë vendimi nr. 1 i datës 11 dhjetor me anekset bashkëlidhur të statusit të Partisë Demokratike, vendimet e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike. Kundër këtij vendimi, i nderuar, është bërë një ankim nga deputeti Enkelejd Alibeaj brenda një afati 15-ditor pranë Gjykatës së Apelit të juridiksionit të përgjithshëm të Tiranës, i cili me vendimin nr. 44, të datës 3.3.2023 ka vendosur mospranimin e ankimit të Partisë Demokratike të Shqipërisë, i përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, të ushtruar në vendimin nr. 508 të regjistrimit themeltar të datës 22.4.2022 me objekt disponim ankimi të Gjykatës së Rrethit

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

Gjyqësor Tiranë, si dhe ka vendosur prishjen e vendimit të datës 25.3.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate me tjetër trup gjykues, por pa i hyrë themelit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kundër këtij vendimi ka vendosur po kjo gjykatë, lejohet rekursi brenda 5 ditëve, duke filluar nga afati i ditës së nesërme kur zbardhet vendimi. Kjo do të thotë në këtë kuptim, vendimi i shkallës së parë i rrethit gjyqësor Tiranë është një vendim që akoma i gëzon efektet dhe ende nuk është prishur para se të kalojnë afatet e parashtruara nga vendimi i Gjykatës së Apelit. Në funksion të regjistrimit si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme vendore të datës 14.5.2023 për kryetar të bashkive, Partia Demokratike ka detyrimin politik, publik e ligjor të paraqesë kërkesën përkatëse për regjistrim si subjekt zgjedhor pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sipas parashikimeve të nenit 64 të Kodit Zgjedhor. Në raport me kornizën ligjore ekzistuese, ne konstatojmë se gjendja aktuale e organeve të saj më të larta drejtuese të krijuara me vullnet të lirë nga anëtarësia, sipas disponimeve të ligjit për partitë politike, i ndryshuar, nuk rezulton të jetë pasqyruar në regjistrin e partive politike për shkak të të gjithë historikut që thashë më lart dhe që t'i vihet në dispozicion KQZ-së në përmbushje të nenit 64 të Kodit Zgjedhor. Për sa më sipër, i nderuar, ne sjellim disa argumente, që duhet të regjistrohemi sot pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si subjekt politik pjesëmarrës në zgjedhje, pasi Kuvendi i Partisë Demokratike i datës 11 dhjetor, si dhe statusi i Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe organet e partisë që burojnë prej tij dhe aktet ligjore në fuqi të regjistrueshme në regjistrin e partive politike sipas dispozitave të ligjit për partitë politike janë ende në fuqi. Gjithashtu janë të regjistrueshme dhe duhet të merren parasysh nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Ndërkohë, edhe vendimi nr. 3 i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë datë 25.3.2022, i cili ka certifikuar Kuvendin Kombëtar të Partisë Demokratike të datës 11 dhjetor 2021 është ende një vendim në

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

fuqi dhe i pashfuqizuar, që mund të zbatohet e mund të merret në konsideratë. Ndërkohë Gjykata e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm ka dhënë vendimin nr. 44 të datës 3.3.2023, i cili është një vendim jopërfundimtar dhe jo i formës së prerë në kuptimin e parashikimit të nenit 451, po bëjmë pak interpretim juridik këtu, shkronja “ç”, të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, pasi ai vendim do të rekursohet nga ana e Partisë Demokratike brenda afatit ligjor të përcaktuar në këtë vendim në momentin që do të dalë vendimi i arsyetuar i Gjykatës së Apelit pasi askush nuk e disponon deri më tani vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Apelit. Kështu që ne mund të flasim këtu që kemi një vendim të ndërmjetëm të Gjykatës së Apelit dhe jo një vendim të formës së prerë, i cili ezauron plotësisht në mënyrë shteruese në lidhje me regjistrimet që unë kam përmendur më lart në regjistrin e partive politike. Pra, që do të thotë që vendimi shkallës së parë që ne disponojmë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor që ia kemi bashkëlidhur gjithë praktikës sonë, ku është më se e plotësuar me kërkesën për regjistrim si subjekt politik në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është në fuqi dhe në këtë moment mund të merret parasysh nga Komisioneri Shtetëror për të bërë regjistrimin e Partisë Demokratike. Ndërkohë, i nderuar, rekordet e organeve drejtuese të Partisë Demokratike të Shqipërisë që figurojnë të pasqyruara në regjistrin e partive politike janë të vjetra dhe nuk është se pasqyrojnë korrektësisht organet drejtuese, të cilat kanë buruar nga kuvendet e Partisë Demokratike, sidomos e atij të fundit të datës 11 dhjetor, organe të cilat janë të zgjedhura me votë drejtpërdrejt nga anëtarësia, veçanërisht për sa i përket ish-kryetarit të Partisë Demokratike, zotit Lulzim Basha, i cili figuron ende, por që aktualisht nuk është kryetar i Partisë Demokratike. Kjo, për shkak se është shkarkuar nga anëtarësia në kuvendin e 11 dhjetorit, ndryshime të cilat tashmë janë në fuqi me një vendim gjykate. Është shkarkuar edhe me votim masiv po nga anëtarësia, i cili qëndron po me vendim gjykate të rrethit gjyqësor Tiranë në fuqi.


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

Ndërkohë edhe vetë zotëria ka bërë një akt publik, ka dhënë dorëheqjen në mënyrë publike. Duke parë që dorëheqja është një akt tërësisht personal dhe që hyn direkt në fuqi, këto ndryshime nuk janë arritur të bëhen në regjistrin e partive politike për shkak të situatës që ka ndodhur. Ndërkohë, kërkesa për regjistrim e subjektit zgjedhor të Partisë Demokratike në zgjedhje sipas nenit 64, nen të cilit i referohemi dhe është neni përcaktues për regjistrimin e forcave politike pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si subjekte zgjedhore, Kodit Zgjedhor dhe akteve të tjera që lidhen me të, dhe që i janë bashkëlidhur kërkesës sonë, i nderuar, janë akte ekskluzive që i takojnë kryetarit të partisë dhe nuk mund të delegohen nga askush tjetër. Kështu që, edhe nga kjo pikëpamje, edhe nga ana formale, edhe nga ato që përcakton Kodi, ne i kemi të plotësuar kërkesat dhe dokumentacionin, dhe e kemi dërguar pranë jush në atë formë të kërkuar dhe të praktikuar, tashmë, edhe nga praktika e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kështu për sa të gjitha thashë më sipër dhe të gjithë dokumentacionin, të cilin ne kemi depozituar para jush, si në këndvështrimin tonë, si në këndvështrimin e ligjor, por edhe nga praktika e deritanishme e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili ka pasur praktikë që ka regjistruar forca politike, si subjekte zgjedhore edhe më përpara vetëm me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ne kërkojmë të regjistrohemi si subjekt politik pjesëmarrës në zgjedhjet kombëtare për zgjedhjet lokale të 14 majit të vitit 2023. Të mos shohim dhe të mos rrezikojmë proceduralisht, që për herë të parë, që nga viti 1990 deri më sot të mos mbetet pa regjistruar partia më e madhe opozitare në vend. Kjo do të jepte një goditje shumë të madhe pluralizmit dhe zgjedhjeve në vendin tonë, të cilat dihet sa të brishta kanë qenë deri tani. Nisur nga sa më sipër, nga i gjithë ky dokumentacion që ju dispononi, ne kërkojmë para jush sot, në këtë seancë dhe debat publik, i nderuar, regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë, si subjekt zgjedhor për zgjedhje të përgjithshme vendore të datës 14.05.2023, në

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

përputhje me parashikimet e nenit 64 të Kodit Zgjedhor dhe të gjithë praktikës së krijuar deri më sot nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit juve! Po, zoti Sefa, fjala është për ju.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Unë jam përfaqësuesi i Partisë Demokratike.


**Z. I. Celibashi:** Patët edhe mirëkuptimin e zotit Sefa, kështu që vazhdoni.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Faleminderit! Në vijim të asaj që shprehu edhe kolegu Ledio Nuraj, desha të relatoj vetëm dy gjëra të rëndësishme më tepër për publikun.

**Z. I. Celibashi:** Ju lutem, shkurt!

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Shumë shkurt do të flas. Ajo, që është e rëndësishme për të gjithë që ta kuptojmë, është se nuk është fleta e regjistrit të partive politike që e bën dikush kryetar partie, por është anëtarësia e partisë. Janë anëtarët që e kanë votuar kryetarin e partisë ata që e bëjnë kryetar dhe e mbajnë në detyrë. Këtu, para jush, i nderuar Komisioner, ju keni dy dosje për të shqyrtuar për Partinë Demokratike. Ne gjykojmë që dosja jonë është e plotë dhe i ka të gjitha elementet e kërkuara. Ajo që mund të konstatohet është se te regjistri i partive politike për shkak të një problematike administrative, por edhe zvarritjeje të proceseve gjyqësore figuron ende emri i kryetarit të vjetër të partisë, pra ish-kryetari zotit Basha. Por nuk mundet tani, që bazuar vetëm në këtë fakt, të regjistrohet ish-kryetari, i cili ka dhënë dhe dorëheqjen dhe vetë e pranon se nuk është më kryetar i kësaj partie. Nga ana tjetër, Partia Demokratike, e përfaqësuar nga zoti Sali Berisha, e ka të gjithë tagrin

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

ligjor për t'u regjistruar në zgjedhje, sipas mendimit tonë, asgjë nuk e pengon. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka pasur edhe precedent të mëparshëm që ka regjistruar subjekt zgjedhor dhe thjesht dhe vetëm me vendim të gjykatës së shkallës së parë. Madje kemi rastin e Bindjes Demokratike precedent, i cili brenda 24 orëve nga dhënia e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka regjistruar pa kaluar afati ligjor prej 15 ditësh. Ndërkohë sot në rendin e ditës ne vërejmë se në pikën 5 është parashikuar edhe diskutimi çështjes së Lëvizjes Bashkë. Një subjekt zgjedhor që, nga ato që kemi parë si dokumente dhe materiale, disponon një shkurtim vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë të para pak ditëve, pra që nuk ka kaluar ende afati 15 ditor, gjithashtu. Me sa shoh nuk ka ende pasqyrimin në regjistrin e partive politike. Pra, shkurtimisht, pa e zgjatur, ne gjykojmë se KQZ-ja i ka të gjitha mjetet dhe të gjitha mundësitë ligjore procedurale, që të shkojë përtej germës së ligjit, por të vendosë bazuar mbi të drejtën. Ne gjykojmë se Partia Demokratike e përfaqësuar nga zoti Sali Berisha duhet të regjistrohet si subjekt zgjedhor. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Po, zoti Sefa, fjala për ju.

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PD:** Faleminderit, i nderuar, zoti Komisioner! Më vjen mirë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është kaq i hapur në debatin politik. Madje është edhe shumë i hapur në debatin gjyqësor duke kaluar edhe në nostalgjinë që ka edhe Komisioneri, si ish-gjyqtar, mund ta bëjmë edhe debatin. Kemi konkluzionet e paraqitura në Apel, rreth 45 faqe, nëse Komisioneri ka kohë, mund t'i dëgjojë me vëmendje, dhe të marrë edhe një vendim gjyqësor mbi atë të Gjykatës së Apelit, që ishte i ezauruar. Nëse Komisioneri mendon se e ka këtë kompetencë atëherë mund t'i hyjmë edhe këtij debati, mund të jetë edhe debat shterues njëherë e përgjithmonë,

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

nëse Komisioneri ka kohë dhe publiku është i gatshëm për ta dëgjuar. Nuk na e dha mundësinë Gjykata e Apelit që ta bënim gjyqin të transmetuar *live*, me që jemi, ta shfrytëzojmë edhe këtë hapësirë. Së pari.

**Z. I. Celibashi:** Keni të gjithë mundësinë të shfrytëzoni transparencën e institucionit të KQZ-së, jeni të lutur.

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD:** Jep dokumentet bashkëlidhur Komisionerit dhe jemi në rregull!

**Z. I. Celibashi:** Dakord Ledio, ta respektojmë kolegun! Është më së shumti kolegu juaj.

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PD:** Zoti Komisioner, unë ju dëgjova me shumë vëmendje dhe me shumë dashamirësi, madje duke qenë në këtë debat dhe duke i kthyer përsëri profesionit të vjetër të Komisionerit, kërkoj një kopje të praktikës së paraqitur nga zoti Berisha të njihem pak me praktikën ju lutem, të më vihet në dispozicion!

**Z. I. Celibashi:** Po, e kemi një kopje të dokumentacionit, e doni hard copy apo elektronikisht? Mund t'jua përcjellim direkt tani.

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PD:** Dua një kopje ta shoh dhe mundësisht t'i vihet në dispozicion publikut, sepse, ato që do të ngre, janë arsye për të cilat bën mirë që edhe publiku të njihet.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

**Z. I. Celibashi:** Dakord. E doni tani ne email apo e doni të printuar? Ju lutem një kopje.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL:** Zoti Komisioner, a mund ta marr fjalën?

**Z. I. Celibashi :** Jo, kemi 5 minuta pushim.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL:** Ndërkohë që bëhet kopja për zotin Sefa, do të doja të thosha...

**Z. I. Celibashi:** Kemi 5 minuta pushim, nuk jemi në seancë. E kemi ndërprerë seancën.

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PD:** A fillojmë, zoti gjyqtar? Se, meqë jam avokat të del vesi me shpirtin.


**Z. I. Celibashi:** Edhe mua ma gudulis sedrën.

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PD:** Këtë gabim e kam bërë disa herë në këtë sallë.

**Z. I. Celibashi:** Profesion i nderuar.

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PD:** Vendimi nr. 3 datë 25.03.2022, është ky vendimi. Nëse Komisioneri më gjen një element procedural që ka dalë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vulën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, unë mendoj që Komisioneri ta marrë në konsideratë. Ky është një vendim gjykate, i cili nuk

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

përmbush kushtet themelore për të qenë i tillë, që do të thotë: nuk ka shënim nga rrethi Gjyqësor Tiranë, as pullë dhe as vulë. Dhe ju besoj se si ish-gjyqtar e dini mirë që këto vendime jo vetëm nuk janë të ekzekutueshme, jo vetëm që nuk noterizohen, që për fat të keq është noterizuar, për fat të keq është noterizuar, por nuk mund të sjellin asnjë efekt dhe nuk mund t'i drejtohen asnjë institucioni publik për t'u zbatuar. Po e lë me kaq këtë.

Së dyti, në asnjë rresht të këtij vendimi nuk shkruhet, mund t'jua jap përsëri, se janë dokumente origjinale dhe mund të na lindin diskutimet e modelit që humbën shkresat, nuk shkruhet në asnjë moment zoti Sali Berisha kryetar i Partisë Demokratike. Kërkesa është Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit. Nëse këtu do të vihej me një kërkesë për regjistrim do të ishte Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, të cilit i ka mbaruar mandati në prill të vitit 2022. Prandaj, them se, nëse doni t'i hyjmë debatit gjyqësor, jam shumë i lumtur mund ta bëj, edhe për efekt të publikut, do të isha shumë i lumtur të them të drejtën. U ngrit një pretendim tjetër: nuk është regjistruar, është regjistrimi i vitit 2018 dhe të gjitha me radhë. Ke vendimin nr. 10 datë 13.07.2021. Janë regjistruar të gjitha organet e Partisë Demokratike, të gjitha ndryshimet, është regjistruar edhe zgjedhja e Kryetarit më 13 qershor të vitit 2021, por nuk ka qenë pjesë e dokumentacionit, sepse këtij komisioni nuk i duhet ky dokumentacion. Ligji është i qartë, thotë: vërtetim që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, emri, mbiemri dhe adresa e kryetarit të partisë, i cili është personi i autorizuar për të paraqitur kandidaturat emri zyrtar është kryenistori, specimeni me vulën e partisë, emri mbiemri, adresa, financierin e partisë dhe emrin e mbiemrin adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në. Këto janë dokumentacionet që duhet të marrë në shqyrtim Komisioneri. Ndaj dhe thashë që në krye të herës që Komisioneri zakonisht, siç e ka traditë ky komision, del me projektvendim. Në këtë rast nuk ka dalë me

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

projektvendim. Po ne nuk e kemi problem, nuk është problem kjo se jemi në gjendje të përgjigjemi për të gjitha kërkesat që mund të vijnë nga komisioni dhe në çdo kohë. Prandaj, i nderuar Komisioner, unë nuk dua t'i hyj më tej këtij debati, nuk është momenti për të bërë debat politik midis demokratëve dhe nuk është momenti, as ky ambient për të treguar se kush e ka legjitimitetin. Ka gjykata të cilat janë shprehur. Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*


**Z. I. Celibashi:** Ju lutem, se duhet të vendosim pak rregull!

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD:** Për procedurë e kisha unë.

**Z. I. Celibashi:** Fjalën e ka përfaqësuesi i Partisë së Lirisë.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL:** Faleminderit, zoti Komisioner! Po dëgjoj këtu një debat të dy palëve që janë të së njëjtës parti, sinqerisht ndjej keqardhje. Sa i përket pjesë së formës dhe përmbajtjes së kërkesave ju duhet t'i shqyrtoni me shumë përkujdes dhe vëmendje. Mendoj se çfarë tha kolegu Nuraj qëndron sa i përket pjesës së formës kur partia politike organizohet në vetvete, në bazë të ligjit për partitë politike dhe në bazë të statutit të saj. Është vullneti i përfaqësuesve të kësaj partie, i cili ka dëshmuar publikisht se cila është Partia Demokratike e Shqipërisë. Nuk do të doja në asnjë rast që fraksione të tilla, siç është, me shumë respekt e them për kolegun se kolegu është përfaqësues i saj, fraksione të tilla të krijojnë një dëm të karakterit publik në Republikën e Shqipërisë duke i servirur vetë në një pjatë të argjendi Partisë Socialiste, atë që është vetë objektivi i saj. Do të duhet që e gjithë opozita e bashkuar, të mbrojnë interesin publik të zgjedhësve të vet, interesin publik

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

të zgjedhësve të vet, interesin publik të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, rekomandimet e pa diskutueshme të OSBE-ODIHR-it, të cilat janë kambana alarmi në çdo rekomandim të tyre, qoftë dhe ky i fundit që ka dalë. Do të doja në çdo rast, që ju siç keni bërë shpesh me objektivitet të vlerësoni, atë që është articipiteti i kësaj çështjeje për shkak se nuk mendoj dhe besoj, të paktën nga eksperiencia ime në këtë institucion, të ketë një precedent të mëparshëm, lidhur me rivendikimin e asaj që është, të themi, forma dhe përmbajtja e një kërkesë drejtuar jush, për sa i përket parashikimeve të ligjvënësit në pikën e parë të nenit 64. Kështu që i bëj thirrje Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i bëj thirrje të gjitha organeve që kanë interes të karakterit publik të mos bëhemi lojë e një politike, e cila lë një Gjykatë Apeli të vendosë në 8 orë një gjë të palogjikshme duke ushtruar ndikim të paarsyeshëm te gjyqësori. Pavarësisht kësaj rezulton, se ashtu, siç saktë e tha kolegu Nuraj, ende në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë rezulton të depozituara aktet e të ashtuquajturit Komision të Rithemelimit sa i përket vendimmarrjes të bërë në vokspopuli nga vetë anëtarësia më e lartë e saj, anëtarësi që ka qenë publike, transparente. Çdo veprim i bërë nga Komisioni i Rithemelimit ka qenë në përputhje me ligjin. Kështu që edhe një herë e sjell në vëmendjen tuaj faktin e karakterit publik të lartë, që ka kjo çështje, ndonëse unë jam përfaqësuesi i një partie të tretë, pavarësisht të gjithave, kjo çështje ka interes të lartë publik, dhe ju këtë gjë e dini, me eksperiencën që keni normalisht duhet të vendosni me shumë objektivitet. Kërkoj që kjo çështje të zgjidhet sa më parë pa i krijuar asnjë dëm asaj që realisht është Partia Demokratike e Shqipërisë, për shkak të zgjedhësve të saj e vendosin ata se cili është subjekti politik që duhet të përfaqësojë Partinë Demokratike të Shqipërisë në këtë institucion. Pa vonesa të mëtejshme për shkak të afateve dhe për shkak të organizimit që duhet bërë për të vazhduar më tej për ato që janë platformat tona politike si opozitë e bashkuar. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

**Z. I. Celibashi:** Po, zoti Nurja, shumë shkurt dhe pastaj përsëri për zotin Sefa.

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD:** Thjesht, për procedurë, doja të sillja në vëmendjen tuaj dhe të gjithëve që ne këtu jemi në një seancë për regjistrimin e partive politike si subjekt zgjedhor. Nuk jemi në seancë gjyqësore, apo që të ketë palë të interesuara. Kjo do të thotë, raporti këtu është midis objektit dhe Komisionerit dhe nuk kemi palë të interesuara që të kërkojnë dokumentacione apo të jepen dokumentacione. Jo se kemi ndonjë problem me dokumentacionin që kemi sjellë apo ndonjë fshehtësi, pasi dokumentacioni që ne kemi sjellë është bërë publik dhe është dokumentacion autentik dhe i kërkuar sipas ligjit për partitë politike ashti siç e kërkon dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Është një dokumentacion, i cili edhe një kërkesë e firmosur nga kryetari i partisë me kryetar partie dhe jo me kryetar fraksioni. Është një kërkesë, e cila ka një shkresë përcjellëse për dokumentacionin bashkëlidhur. Po të jetë për të kërkuar dokumentacione edhe ne mund të kërkojmë shumë mirë dokumentacione, pavarësisht se nuk do të donim fare debat me pjesën e fraksionit të Partisë Demokratike në këtë seancë. Mund të kërkonim shumë mirë dokumentacione, të cilat siç dihet tashmë janë dokumentacione pa emër kryetari, pa firma dhe pa vula. Janë me ato vulat e vjetra të cilat janë shfuqizuar me kohë nga anëtarësia e Partisë Demokratike nëpërmjet kuvendeve dhe vendimeve që janë marre nëpër ato kuvende dhe me votime të drejtpërdrejta. Kështu që, ky është një debat që nuk duhet të bëhet fare këtu, por këtu duhet të bëhet ajo për të cilën ne kemi ardhur. Të shqyrtohet dokumentacioni, të krahasohen dokumentacionet dhe të vendoset mbi dokumentacionin ligjor se cila e ka paraqitur ashtu siç duhet në kërkesë të ligjit. Faleminderit! Koment tjetër nuk kam për ato që tha zoti Sefa ato janë gjëra që këtu hidhen për konsume mediatike. Partia Demokratike është, ka qenë, ekziston dhe do të ekzistojë. Është ajo Parti Demokratike që ka zgjedhësit, ka anëtarësinë e saj, atë

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

parti që e njeh anëtarësia, ka kryetarin e saj, atë kryetar që është zgjedhur në përputhje me të gjitha statutet e Partisë Demokratike, që është zgjedhur në përputhje me Kushtetutën, me të gjitha normat që normojnë lirinë dhe demokracinë në Shqipëri, dhe këtu nuk kemi fare asnjë dyshim. Për ato që thotë kolegu Sefa, janë për konsum mediatik apo për konsume gazetareske. Kështu që, i nderuar, t'i përmbahemi çështjes dhe rendit të ditës për të cilën kemi ardhur. Ku janë të gjithë anëtarësia e Partisë Demokratike, anëtarësi reale dhe jo anëtarësi *fake*, me sy dhe me vesh sot në këtë seancë, ku është përgjegjshmëria më e madhe e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të bëjë regjistrimin e Partisë Demokratike, të asaj partie që mbështetet nga anëtarësia dhe nga zgjedhësit e saj. Pasi është një çështje shumë sensitive kjo, që po trajtojmë ne sot. Faleminderit!


**Z. I. Celibashi:** Po, si kërkesat e deputetëve për procedurë.

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PD:** Zoti Komisionier, kolegut Nuraj nuk kam dëshirë t'i kthej përgjigje, sepse e kam dhënë përgjigjen edhe gjyqësisht edhe në seancë gjyqësore. Këtu jemi në seancë drejtuar KQZ-së, por një përgjigje kisha për kolegun e Partisë së Lirisë, i cili mendon se ka ndryshuar emrin, po me ndryshimin e emrit nuk ndryshon historia. Se kush i ka shërbyer Edi Ramës, historia e tregon qartë.

**Z. I. Celibashi:** Unë kam vetëm një këshillë, do t'ju lutesha që t'i evitonit retorikat politike se ...

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PD:** Nuk mund të vijë përfaqësuesi i partisë tjetër dhe të thotë patericë dhe fraksione e këto gjëra, se kjo nuk mund të qëndrojë në këtë seancë publike.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*


**Z. I. Celibashi:** Jam dakord që t'i evitojmë për sa është e mundur, se unë nuk mund të kontrolloj në narrativën tuaj askënd prej jush, por këshilla ime është që t'i evitojmë retorikat politike, sepse, të paktën, këtu e keni të qartë që nuk përcaktojnë në vendimmarrje.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL:** Jo nuk e kam për debat, temperamentit i kolegut Sefa nuk do të thotë që ai ka të drejtë. Duhet të ruajë qetësinë, do të duhet të shohë interesin publik, nuk duhet të shohë me meskinitet interesat vetjake ose të atij grupimi që përfaqëson, një grupim shumë i ngushtë, i cili mund të numërohet në duart, në gishtat e një dore. Faleminderit!

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PD:** Po, si me anëtarët e një familjeje.

**Z. I. Celibashi:** Ju lutem, ta evitojmë, është pa sens i gjithë ky diskutim dhe ju e kuptoni shumë mirë, për ata që na ndjekin e kuptojnë që nuk ka ndonjë relevancë ky lloj diskutimi për çështjen. Kështu që këshilla ime miqësore është: kursejani vetes këtë mënyrë të diskutuari. Mirë, besoj se nuk kemi tjetër çfarë të presim në lidhje me atë çfarë u prezantua nga të interesuarit, në lidhje me kërkesën për regjistrimin e Partisë Demokratike. Së pari, dua të them se unë jam i bindur që secili prej jush, po pas jush edhe autorizuesit tuaj, kanë bindjen që vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, personit në fjalë, bazohet tërësisht në argument ligjor dhe jashtë çdo lloj interesi politik apo tjetër, se edhe kjo është shumë e rëndësishme, në fakt.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 9.03.2023*

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD:** Po, i nderuar, bindja jonë qëndron, sidomos tek ato që kemi dorëzuar konform ligjit.

**Z. I. Celibashi:** Nuk e vë në diskutim për të gjitha palët. Thashë edhe për autorizuesit tuaj, se përndryshe nuk do të kishte kuptim, çfarëdolloj që do të vendosnin. Kam përshtypjen që për të gjithë është e qartë, së pari, që ne do të duhet të sqarojmë se cili është organi apo personi drejtues i personit juridik, në këtë rast i Partisë Demokratike, që ka të drejtën për të paraqitur kërkesën për regjistrimin si subjekt zgjedhor. Për KQZ-në mjafton që të jetë e provuar se kush e ka këtë legjitimitet, pra kush është personi, i cili përfaqëson Partinë Demokratike me të tretët apo edhe cili është organi drejtues i kësaj partie. Pyetja është që kush vendos për këtë gjënë, a vendos Komisioni Qendror i Zgjedhjeve? Pra, vendos Komisioneri se kush është organi drejtues i një partie politike apo se cili është personi? *(Ndërhyrje pa mikrofon)* Jo, kemi mbaruar me diskutimet, jemi duke arsyetuar çfarë ju prezantuat dhe dokumentacionin shoqërues të kërkesës suaj, i cili do të pasohet me vendimmarrjen time më pas. Pra, është e qartë që KQZ-ja nuk e ka këtë atribut, pra nuk është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk është Komisioneri Shtetëror, i cili përcakton se cili person apo organ është përfaqësues i një partie politike, është drejtues i një partie politike. Nuk ka asnjë parashikim të tillë në Kodin Zgjedhor apo në ligjin për partitë politike apo dhe në legjislacionin tjetër, ku të përcaktohet që është kompetencë e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve apo e KQZ-së, të themi, për të vendosur se cili është organi drejtues apo përfaqësuesi i një partie politike. Pra, besoj që biem të gjithë dakord për këtë. Atëherë pyetja është: nga i merr Komisioni Qendror i Zgjedhjeve këtë të dhënë dhe këtë informacion, se përderisa ne nuk e kemi, duhet ta ketë dikush tjetër. Pyetjet janë retorike, nuk janë pyetje për ju, se e bëra sqarimin, jemi duke arsyetuar vendimmarrjen. *(Ndërhyrje pa mikrofon)* Po,

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

pra, përderisa pranon që nuk është KQZ-ja, do të thotë që është dikush tjetër, institucion apo organ, por jo KQZ-ja. KQZ-së i paraqitet dokumentacioni, i cili tregon se kush është drejtuesi i një partie politike apo edhe përfaqësuesi i një partie politike, që do të thotë që të shohim kush është ky institucion tjetër dhe besojmë se ndajmë të gjithë pikëpamjen dhe bindjen që është gjykata, e cila vendos se cili është personi apo organi drejtues i një partie politike, se nëse nuk është KQZ-ja, do të jetë dikush tjetër, se e pranojnë të gjithë. Jo, po vazhdoj diskutimin, arsyetimin, në rregull. Ju i thatë çfarë kishit për të thënë, unë po përpiqem të arsyetoj vendimin tim.

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD:** Thjesht doja t'ju ndihmoja në arsyetimin tuaj, një ndërhyrje e vogël, që nuk është gjykata që e vendos pasi sipas ligjit të partive politike, gjykata thjesht merr vendimet e partive politike dhe i regjistron te regjistri.

**Z. I. Celibashi:** Të lutem!


**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD:** Më fal, dua thjesht, dhe do t'ju dëgjoj deri në fund.

**Z. I. Celibashi:** Kemi mbaruar me diskutimet...

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD:** Mund të bëjmë edhe ndonjë modifikim gjatë rrugës, të arsyetimit tuaj, por dhe atë jam munduar të shpjegoj gjatë gjithë pjesës dhe fjalës sime dhe kronologjikisht...

**Z. Celibashi:** E kemi mbyllur, zoti Nuraj. Më mirëkupto, e kemi mbyllur këtë.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD:**...në gjykatë dhe gjykata i ka marrë dhe i ka administruar këto akte. Kështu që nuk vendos, por thjesht i merr dhe i regjistron. Ç'ka kanë vendosur, janë vendosur, anëtarësia e të tjera.

**Z. I. Celibashi:** Kam vetëm një pyetje, që po e ribëj edhe një herë: a është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisioneri që vendos se kush e drejton një parti politike?

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD:** Jo.

**Z. I. Celibashi:** Mbaruam ligjin, po vazhdoj me diskutimin...

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD:** Por është ai organ që vendos në lidhje me subjektet zgjedhore.

**Z. I. Celibashi:** Jam dakord, nuk jemi aty tek ajo fazë, po jemi te diskutimi që kush vendos ...

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD:** Për ta vendosur, nuk e vendos Komisioneri, atë e ka vendosur anëtarësia, si për çdo parti tjetër.

**Z. I. Celibashi:** E vendos anëtarësia, dakord jam edhe unë me ju, KQZ-ja nuk e vendos, biem dakord këtu. Jemi të qartë, kaq më duhet për momentin. Pra, jemi të gjithë dakord, që nuk është KQZ-ja, Komisioneri se cili është drejtuesi i një partie politike dhe udhëheqësi i një partie politike.

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD:** Nuk kemi ardhur për këtë, i nderuar.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

**Z. I. Celibashi:** E kam shumë të qartë. Vendos anëtarësia e partisë.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL:** I nderuar, patjetër që vendos anëtarësia, por në këtë rast...

**Z. I. Celibashi:** Të lutem, të mos e bëjmë debat tani. Ju lutem, mos ma prishni seancën!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL:** Zoti Komisionier, vetëm një minutë. E vendos anëtarësia dhe jemi dakord me ju. E vendos vetë ai i ashtuquajtur kryetar, kur jep dorëheqjen që është akt i parevokueshëm. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Mund të vazhdosh. Po çfarë the? Nuk the asgjë me këtë.

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD:** Po, është i ndërgjegjshëm Komisionieri për atë.

**Z. I. Celibashi:** Në respekt edhe të dijës së gjithsecilit prej nesh, po edhe të atyre që na ndjekin, të paktën, formalisht le ta bëjmë përmbajtjesor këtë diskutim. Unë e di shumë mirë dhe ju e dini se si është vendimmarrja e këtij procesi, në njohjen reciproke që kemi, po, për këdo të tretë të interesuar, le ta sqarojmë këtë çështje për shkak të rëndësisë së madhe publike që ka. Kështu që bën sens që të krijojmë kushtin për të dëgjuar njëri-tjetrin dhe argumentet e gjithsecilit.

**Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD:** I nderuar, a mundem?

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

**Z. I. Celibashi:** Po, të lutem, tani!

**Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD:** Vetëm për procedurë, për asgjë tjetër.

**Z. I. Celibashi:** Jo, nuk ka asgjë për procedurë. Ju lutem, jam duke arsyetuar në lidhje me vendimmarrjen, nuk ke se çfarë të thuash, i tha të gjitha kolegu juaj.

**Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD:** Diçka që dua ta them, se nuk e ka thënë. Kanë dalë çështje rishtas prandaj.

**Z. I. Celibashi:** Cilat çështje kanë dalë rishtas? M'u përgjigj, cilat çështje kanë dalë rishtas?

**Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD:** Çështje procedurale.

**Z. I. Celibashi:** Cilat?

**Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD:** Ja po jua them. Referuat në fillim dy kërkesat, që janë paraqitur për subjektin politik.

**Z. I. Celibashi:** Mos u merr me këtë gjë.

**Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD:** Po flas vetëm për procedurë. Kur të dalë vendimi, do të shqyrtohen të dyja kërkesat në një vendim, apo çdo kërkesë do të shqyrtohet me...

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

**Z. I. Celibashi:** Të lutem, po këtë e thamë që në mëngjes, që janë dy kërkesa dhe i shqyrtoam njëkohësisht të dyja kërkesat.

**Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD:** Sepse nuk është shqyrtuar kërkesa e zotit Sefa.

**Z. I. Celibashi:** Për çfarë foli zoti Sefa? Kërkoi që të regjistrohej Partia Demokratike, apo jo zoti Sefa?


**Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD:** Zoti Sefa vetëm kundërshtoi parashtimet e zotit Nurja dhe siç thashë janë... Pra ju referuat, por edhe në rendin e ditës janë dy kërkesa të paraqitura. Në projektvendimin apo në vendimin që ju do të merrni, do të shqyrtohen të dyja kërkesat në një vendim, apo çdo kërkesë do të shqyrtohet më vete? Kaq kisha. Prandaj thashë vetëm për procedurë.

**Z. I. Celibashi:** Po i shqyrtojmë të dyja kërkesat dhe i dëgjuam të dyja palët e interesuara. Të dyja palët e interesuara kërkuan regjistrimin e PD-së. Një zotëri kërkoi regjistrimin e PD-së, me kryetar zotin Sali Berisha, zotëria tjetër kërkoi regjistrimin e PD-së, me kryetar zotin Lulzim Basha.

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PD:** Zoti Komisionier, më vjen keq që keni humbur reflekset e gjykatësit, kur relatton gjykata vendimin, në këtë rast Komisionieri, palët nuk kanë asnjë të drejtë të marrin fjalën.

**Z. I. Celibashi:** Po të isha në rolin e gjykatësit, do të kisha mbajtur qëndrim tjetër, kjo është e natyrshme, po jemi KQZ-ja dhe jemi shumë të hapur me partitë politike.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PD:** Në këtë rast edhe Komisionieri kur relatton vendimin, palët nuk kanë të drejtë për të bërë as kërkesa procedurale, as një kërkesë tjetër. Sa për kolegun unë në fjalën time thash që Komisioneri duhet t'i përmbahet në mënyrë ekskluzive nenit 64 të Kodit Zgjedhor, i cili e përcakton qartë, madje edhe e referova dokumentacionin e nevojshëm që duhet për regjistrimin e partive politike. Por nëse nuk e ka dëgjuar, kërkojmë regjistrimin e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë për zgjedhjet vendore të 14 majit të vitit 2023. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë.

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD:** Vazhdojmë, po dolën të gjitha më duket.

**Z. I. Celibashi:** Meqenëse dolën të gjitha, të vazhdojmë me arsyetimin.

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD:** Për sa referuat, të lutem, më vjen shumë keq që t'ju ndërpres, kur thatë dy forca politike. Vërtet ju nuk e zgjidhni kryetarin, por doja të ndërhyja që kërkesa e ardhur nga Partia Demokratike, me kryetar: një pikëpyetje e madhe. Referuat me kryetar Sali Berisha, referuat Partia Demokratike me kryetar. Do të sjell edhe një herë në vëmendjen tuaj, edhe të opinionit publik, nuk është më kryetar zoti Lulzim Basha, për arsyet që tashmë i dini dhe jua thashë. Kur është zgjedhur ka qenë brenda një procesi gjyqësor me ankimin nga garuesja, është shkarkuar dhe e treta, ka bërë edhe një akt dorëheqjeje publike. Tani që ta sqarojnë është, apo nuk është...

**Z. I. Celibashi:** I thatë.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD:** I thashë, po thjesht po i them edhe një herë meqë e dëgjova që e përmendët. Për pjesën tjetër, për sa i përket regjistrimit, po ju them edhe një herë se regjistrimet janë shumë të vjetra, ka procese që janë zhvilluar në lidhje me Partinë Demokratike, thjesht duhet të mbahen parasysh, meqenëse po shqyrtohen të dyja njëherësh ...

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Vetëm 30 sekonda, i nderuar Komisionier. Meqenëse po shqyrtohen të dyja kërkesat njëkohësisht, dhe ne kemi disa argumente dhe disa fakte që duam t'i bëjmë publike në lidhje me dokumentacion e paraqitur nga fraksioni tjetër. Aty ka të dhëna të pasakta, përveç emrit të kryetarit..,

**Z. I. Celibashi:** Ju duhet të kuptoni një gjë: që çfarë jeni duke relatuar tani, është tërësisht në një mosrespektim të thellë të institucionit të KQZ-së, por konsideruar që raporti i këtij institucioni me partitë politike është shumë i hapur dhe mirëkuptues, unë po jua jap këtë të drejtë, por ka vetëm një kusht: do të më thoni që ne nuk kemi më se çfarë të themi, dhe unë do të vazhdoj me arsyetimin. Në rregull?

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PD:** Komisioner, diçka: në qoftë se do të merren edhe kompetencat e KAS-it, jemi dakord ta bëjmë edhe këtu ankimin.... Nëse jeni tërhequr për vendim dhe do të arsyetoni vendimin, arsyetoni vendimin, se këtu do të rrimë deri nesër dhe do të bëjmë debat gjyqësor.

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD:** Meqë është kaq specifike, u përmend disa herë gjykata, edhe këto që mund të them unë, mund t'i verifikoni edhe në gjykatë, i nderuar, për procesin që është ende, e të tjera, meqenëse nuk vendosni dot ju, kush është kryetar, ne do të...

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

**Z. I. Celibashi:** Nuk thashë nuk vendos dot unë, unë thashë dhe mora pohimin nga ju që nuk është KQZ-ja që vendos.

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD:** Thjesht po ju ndihmoj që në vendimmarrjen tuaj t'i keni sa më të qarta të gjitha gjërat dhe të gjitha faktet.

**Z. I. Celibashi:** Kemi gjë tjetër për të thënë? Kemi gjë tjetër për të thënë? Zoti Sefa, kemi gjë tjetër për të thënë? Nuk kemi gjë tjetër.

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PD:** Unë nuk kam pasur që në momentin e parë.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesit e partive të tjera, kanë gjë tjetër për të thënë? Nuk keni gjë tjetër për të thënë. Atëherë sikurse po thosha biem të gjithë dakord që nuk është KQZ-ja institucioni që e përcakton se kush është drejtuesi i një partie politike dhe për sa kohë që KQZ-ja nuk vendos, do të duhet që KQZ-ja këtë informacion ta marrë nga një palë e tretë. Dikush thotë që është anëtarësia, dikush thotë është gjykata, dikush tjetër thotë është një institucion tjetër, ndoshta. Në fakt, e kanë përcaktuar shumë mirë ligji për partitë politike dhe Kodi Zgjedhor. Në ligjin për partitë politike është e përcaktuar qartë se cili është organi që vendos për regjistrimin e partive politike, mbi ndryshimin e organeve drejtuese të partisë politike dhe kjo është gjykata... (Ju lutem, nëse do të merrni fjalën pa leje, do t'ju nxjerr jashtë) Kjo do të thotë që është gjykata dhe një dokument i cili vjen nga gjykata, që përcakton se kush është drejtuesi i një partie politike. Besoj se kjo është e qartë për këdo dhe është e kotë që të vazhdojmë diskutimet, se asgjë nuk e ndihmon argumentin në lidhje me legjitimitetin e atij që do të paraqesë kërkesën për


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

regjistrimin e partive politike. Edhe në nenin 9 të ligjit për partitë politike, po e citoj, ju e dini shumë mirë, por për të tjerët, të tretët, që kanë interes, thuhet: “Regjistrimi i partive politike bëhet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Tiranë, e cila mban regjistrin e partive politike”. Pra, është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila mban regjistrin e partive politike. Më tej dispozita vazhdon: “Në regjistrin e partive politike shënohet numri rendor i regjistrimit, numri i aktit, e të tjera. Ndërmjet të tjerave, emri i plotë i partisë, inicialet e tjera, emri i kryetarit. Pra, ky është dokumenti zyrtar që tregon se një parti politike është e regjistruar, që tregon emrin e një partie politike, që tregon dhe cili është drejtuesi i partisë politike. Anëtarësia e një partie politike, edhe tre të tjerë jashtë anëtarësisë politike mundet të konsiderojnë dhe të njohin për drejtues të një partie politike këdo që ata çmojnë dhe vlerësojnë se mund të jetë kryetari i partisë politike. Por për ligjin dhe për institucionet publike përfshirë këtu edhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ajo çfarë merret në referencë është dokumenti zyrtar. Do të ishte madje shumë e dëmshme nëse KQZ do ta merrte këtë vendim bazuar mbi perceptime apo edhe mbi fakte publike për sa kohë që ekziston një dokument zyrtar që tregon dhe vërteton një fakt të caktuar. Unë mund ta pranoj që në perceptimin tim zoti Sali Berisha është kryetar i Partisë Demokratike por kjo nuk ndryshon absolutisht asnjë gjë në përputhje me ligjin. Sepse në referim do të duhet të marrë atë çfarë një dokument zyrtar i prodhuar nga një institucion i ngarkuar me ligjin sikurse është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për ta prodhuar tregon një fakt të ndryshëm nga ajo të cilin unë apo dikush tjetër e percepton. Ne jemi të detyruar të zbatojmë dhe të marrim në konsideratë atë çfarë është e pasqyruar në një dokument zyrtar. Përndryshe do të duhet që për analogji edhe në rastin kur do të duhet të vendosim për rezultatin e zgjedhjeve do të duhet që unë të vendos bazuar në atë se si unë e mendoj që kush është partia që mund ta drejtojë më mirë këtë vend, po nuk do të vendoset kështu dhe besoj kjo është e qartë. Dhash një shembull

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 9.03.2023*

kaq të qartë për të kuptuar edhe rastin të cilin kemi në diskutim. Pra, për ta përfunduar mendoj që të drejtën për të kërkuar regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, bazuar në dokumentet zyrtare të cilat i janë vënë në dispozicion Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e ka zoti Lulzim Basha. Ai figuron kryetar i Partisë Demokratike në pikëpamje të ligjit, të kuptimit dhe të interpretimit të dokumentacionit. Vijmë tek diskutimi tjetër në lidhje me legjitimitetin e kësaj kërkesë, të paraqitur ose me të drejtën për t'u paraqitur nga zoti Lulzim Basha. Nga vlerësimi që i kemi bërë këtij dokumentacioni pasi thash dhe nuk do ta përsëris edhe njëherë, është e qartë, kjo e drejtë i takon zotit Basha. Do të duhet që sipas ligjit kërkesa për regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor të paraqitet nga kryetari i Partisë Demokratike zoti Lulzim Basha. Ligji i njeh të drejtën jo vetëm Kodi Zgjedhor por edhe legjislacioni tjetër Kodi Civil njeh të drejtën dhe mundësinë që disa kompetenca të kryetarit të partisë, po sikurse dhe të çdo organi drejtues të një personi juridik ti delegojë tek persona të tretë. Në vlerësimin që i kemi bërë dokumentit autorizues të dhënë nga zoti Basha për zotin Sefa dhe për të tjerë, ne dhe në tërësi në vlerësim të gjithë dokumentacionit që është paraqitur me tagër të plotë të themi nga zoti Basha për të kërkuar regjistrimin e Partisë Demokratike, unë vlerësoj se ky dokumentacion nuk është i plotë dhe në përputhje të plotë me parashikimet e Kodit Zgjedhor. Besoj që është e qartë dhe për ju zoti Indrit por edhe për këdo tjetër që...

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PDSH-së:** Jo, nuk është e qartë të them të drejtën...

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së:** Tju dëgjonim deri në fund pastaj të bënim ndërhyrjet..

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

**Z. I. Celibashi:** Jo, nuk ka më ndërhyrje pas kësaj por gjithsesi. Besoj që është e qartë edhe për ju që dokumentacioni autorizues duhet të jetë në përputhje me parashikimet e nenit 64 të Kodit Zgjedhor. Atëherë, pse thatë që nuk është e qartë?


**Z. I. Sefa, përfaqësues i PDSH-së:** Është shumë e qartë për ne por interpretimi që bën Komisioneri....

**Z. I. Celibashi:** Po pra. Nuk kam vajtur tek interpretimi akoma është e qartë që vlerësimi do të bëhet në përputhje me parashikimet e nenit 64. Po pra, prandaj iu thashë që u nxituat që thatë nuk është e qartë.

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së:** Po patjetër.

**Z. I. Celibashi:** Unë nuk e kisha thënë ende. Vazhdojmë, sipas vlerësimit tim në përputhje me këtë parashikim të Kodit Zgjedhor duhet që akti autorizues të jetë i qartë. Çfarë kuptojmë që me aktin autorizues të jetë i qartë? Do të thotë që kush e lëshon autorizimin të jetë e qartë, kush autorizohet të jetë e qartë, edhe përmbatja ose veprimet që duhet të kryejë i autorizuari duhet të jenë të qarta. Në lidhje me atë se kush autorizon qartësia është e plotë, sepse ka të drejtën që zoti Basha të autoizojë këdo që ai çmon për të paraqitur kërkesa në emër dhe për llogari të Partisë Demokratike përfshirë edhe kërkesën për regjistrim të Partisë Demokratike. Nuk kemi diskutime dhe paqartësi edhe në lidhje me personin që autorizohet pra me ju. Padiskutim i keni të gjitha atributet nga pikëpamja formale dhe ligjore për të qenë përfaqësues ju si person fizik i autorizuar i Kryetarit të Partisë Demokratike. Vijnë tek komponenti i tretë i qartësisë së autorizimit apo të delegimit të veprimeve që duhet të kryejë i autorizuari. Sipas dokumentit që ju keni paraqitur në vlerësimin

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

tim, kjo qartësi nuk është e plotë. Pse themi që kjo qartësi nuk është e plotë?! Që të jetë e plotë dhe një gjë të jetë e qartë do të thotë që nuk ka vend për një kuptim të dytë ose për një mundësi të dytë të atij veprimi që autorizohet. Çfarë është autorizuar në këtë dokumentin autorizues? Ju jeni autorizuar që të kryeni regjistrimin e Partisë Demokratike në zgjedhjet e vitit 2023. Ju thoni që kjo është mjaftueshëm e qartë ose plotësisht e qartë. Unë mendoj që duhet të jetë plotësisht e qartë dhe që të jetë plotësisht e qartë do të thotë që: nuk ka një mënyrë tjetër pak më të qartë se kjo që është e qartë. Kush është më e qartë se kjo që për ju konsiderohet plotësisht apo edhe mjaftueshëm e qartë. “Autorizohet zoti Indrit Sefa të depozitojë apo të kryejë procedurat për regjistrimin e Partisë Demokratike në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023”. Ndërmjet këtij formulimi të dytë dhe formulimit të parë kush është më i qartë? Është ky i dyti. Sa kohë që ka mundësi për të bërë një formulim të dytë më të qartë se sa i pari do të thotë që nga pikëpamja, të paktën formale, autorizimit i mungon qartësia. Por, të themi për momentin që është kjo qartësi sepse është e qartë që një palë zgjedhje do të zhvilloheshin në vitin 2023, e thashë kështu sepse autorizimi është lëshuar në vitin 2022 në datën 18 Mars nëse nuk gaboj. Mundet të konsiderohet që është mjaftueshëm i tillë që t’jua jap juve këtë të drejtë, përtej kësaj ka dhe një mangësi tjetër në dokumentacionin tuaj. Mangësi që lidhet me detyrimin dhe me përgjegjësinë personale të kryetarit të Partisë Demokratike për të nënshkruar deklaratën. Çdo kompetencë tjetër e kryetarit të partisë mundet të delegohet tek të tretë, thuajse sa kohë që ligji nuk ka vendosur kufizime, sepse rregullat për përfaqësimin në Kodin Civil jam i sigurtë që ju i dini shumë mirë, përcaktojnë që përfaqësimi dhe delegimi mundet të bëhet për çdo lloj kompetence me përjashtim të atyre që ligji i ka ndaluar. Po të themi që çdo kompetencë e kryetarit të partisë politike mund të delegohet tek të tretë, përfshirë edhe një kërkesë kryesore sikurse është kërkesa për regjistrimin e partisë politike dhe le të themi që ju e keni. Deklarata

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.9.03.2023*

e kryetarit të partisë nuk është kompetencë, është përgjegjësi. Si përgjegjësi ajo nuk mund të delegohet. Për analogji detyrimi i dikujt të themi për të kryer shërbimin ushtarak nuk mundet të delegohet. Mora një shembull popullor për të qenë i qartë në argumentin dhe në analogjinë që zgjodha. Duke qenë përgjegjësi, kjo është një përgjegjësi tërësisht personale dhe jo më kot ligjvënësi e ka përkufizuar dhe e ka përcaktuar si të tillë. Si përgjegjësi, jo si kompetencë. Kompetenca mundet të delegohet, përgjegjësia nuk mundet të delegohet. Nuk mundet kryetari i partisë politike këtë përgjegjësi të tijën t'ia ngarkojë dikujt tjetër, edhe nëse ai tjetri pranon ta marrë këtë përgjegjësi. Ndaj duke e konkluduar gjithë këtë arsyetim dhe duke analizuar të gjitha këto premisa përfshirë edhe ato të narrativës së zotit Nuraj, unë vlerësoj që dokumentacioni i paraqitur nga përfaqësuesi i Kryetarit të Partisë Demokratike zoti Lulzim Basha, ku kërkohet regjistrimi i Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, nuk është i plotë për ato arsye çfarë unë ju thash. Ndaj do t'ju jap 48-orë kohë për t'i bërë plotësimet e kërkuara. Domosdoshmërisht për deklartën e kryetarit të partisë politike. Faleminderit, e mbyllim këtë pikë të rendit të ditës! Unë e kam mbyllur ju mund të flisni se nuk mund t'ju ndaloj dot.


**Z. I. Sefa, përfaqësues i PDSH-së:** Një kërkesë të lutem, sa më shpejt pasqyrimin e vendimit se më duhet të bëj ankim.

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së:** Edhe ne ju lutem do të donim një kopje të dokumentacionit, sepse shikoj që në këto autorizime mund të kemi element të fallsitetit edhe të shkeljes së ligjit.

**Z. I. Celibashi:** Do tu vëmë në dispozicion çdo gjë që kërkoni! Faleminderit vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës.

**Vendimi nr. 158**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.09.03.2023*

09.03.2023  
Ora 11:29

**RENDI I DITËS**

*Projektakti “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.*

**PJESËMARRJA :**

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Illirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ:      **Z.Y.Merkaj Znj. M. Koja,  
Znj. P.Doçaj**

• **Parti Politike:**      **LZHK, Lëvizja Bashkë, PBD**

• **Të tjerë:**      **KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Po, vazhdojmë me shqyrtimin e kërkesës për rregjistrimin e Partisë Lëvizja për Zhvillim Kombëtar!

**Z. Y. Merkaj:** Partia politike Lëvizja për Zhvillim Kombëtar nëpërmjet kryetarit të saj ka depozituar kërkesën për rregjistrimin e subjektit zgjedhor të kësaj partie, për zgjedhjet e organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Kërkesa e paraqitur është brenda afatit kohor të parashikuar nga pika 1 e nenit 64 të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu pranë KQZ-së është depozituar kërkesa më atë të së cilës Kryetari i Partisë zoti Dashamir Shehi kërkon të rregjistrohet si parti politike me emrin Aleanca Progresiste LZHK dhe jo Lëvizja për Zhvillim Kombëtar. Pjesë e dokumentacionit është edhe kërkesa e dorëzuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.09.03.2023*


Tiranë me objekt ndryshimin e emrit të partisë. Kërkesa mban datën 02.03.2023 dhe rezulton se nuk është shqyrtuar ende nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në këto kushte i kërkojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve kthimin për plotësim të dokumentacionit për rregjistrimin e Partisë Lëvizja për Zhvillim Kombëtar për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po përfaqësues i Partisë Lëvizja për Zhvillim Kombëtar!

**Përfaqësuesi i LZHK:** Faleminderit i nderuar! Atëherë, dua të bëj me dije Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar me datën 16.02.2023, organet e saj vendimarrëse kanë marrë një vendim për ndryshimin e emrit nga Lëvizja për Zhvillim Kombëtar në Aleanca Progresiste LZHK, ankronimi i Lëvizjes për Zhvillim Kombëtar. Pasi është zbardhur ky vendim është depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për tu pasqyruar në rregjistrin e partive politike. Është marrë vërtetimi i dorëzimit edhe vërtetimi i shortimit të çështjes pranë gjykatëses përkatëse pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vënë në dispozicion me dokumentet e tjera të kërkuara në bazë të nenit 64 të Kodit Zgjedhor pranë protokollit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kërkojmë që të bëhet rregjistrimi i emrit të partisë sipas kërkesës së depozituar pra Aleanca Progresiste LZHK. Besojmë që ky emërtim nuk cënon partitë e tjera garuese, duke parë edhe listën e partive të rregjistruara me vendim nga ana e Komisionerit. Kjo është kërkesa jonë i nderuar.

**Z. I. Celibashi:** Po faleminderit! Shumë shkurt sepse pak a shumë arsyetimi në lidhje me vendimin që do të marrë për kërkesën tuaj qendron në substancë për një pjesë për çfarë arsyetova për një pjesë në lidhje me kërkesën e Partisë Demokratike

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.09.03.2023*

për tu rregjistruar si subjekt zgjedhor. I vetmi dokument zyrtar të cilin Komisioneri merr në konsideratë në lidhje me çdo të dhënë për partitë politike është Gjykata e Rrethit gjyqësor Tiranë dhe në mënyrë specifike rregjistri, të dhënat nga rregjistri. Duke konstatuar që të dhënat nga rregjistri janë të ndryshme nga ato të cilat ju keni paraqitur në kërkesë për të mos vendosur rregjistrimin po ju jap 24 orë kohë, se besoj është e mjaftueshme për ta riparaqitur kërkesën në përputhje me parashikimet e ligjit për Partitë Politike dhe të Kodit Zgjedhor. Për respekt ndaj jush jo personal por në raport me ligjin çështja e emrit të partisë politike është çështje substance edhe vendos gjykata edhe në lidhje me emrin. Unë besoj që nuk ka asnjë arsye që të mos ta ketë atë emër Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar emrin e ndryshuar por do të duhet të vendosi gjykata në lidhje me këtë çështjen. Ajo do të vlerësoj nëse emri është në përputhje me parashikimet e Kushtetutës edhe të ligjit për partitë politike, është atributë i tyre! Faleminderit

**Vendimi nr. 156**

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.09.03.2023*

09.03.2023  
Ora11:36

**RENDI I DITËS**

*Projektvedndim “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Bindja Demokratike”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.*

**PJESËMARRJA :**

**KQZ**

**1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Z. Ilirjan Celibashi**

**2. Staf i KQZ:**

**Z. Y. Merkaj, Znj:M. Koja,**

**P. Doçaj**

**Parti Politike:**

**PDSH, Bindja Demokratike, Partia e Lirisë, Lëvizja Bashkë, LZHK**

**OJQ:**

**KRIIK, Përfaqësues nga Shoqëria Civile**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër.

**Z. Y. Merkaj:** Partia Bindja Demokratike ka dorëzuar në KQZ kërkesën për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Kërkesa respekton afatin kohor të parashikuar në nenin 64, pika 1 të Kodit Zgjedhor. Pas verifikimeve përkatëse konstatohet se dokumentacioni i paraqitur nga Partia Bindja Demokratike nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64, pika 2, pasi në hyrje të kërkesës për regjistrim rezulton emri si kryetar i zotit Astrit Patozi ndërsa në përmbajtje të kësaj kërkesë është zoti Fabian Topollaj si kryetar i kësaj partie. Gjithashtu modeli miratuar nga KQZ-ja për hapjen e llogarisë bankare nga subjekti zgjedhor, është nënshkruar nga zoti Fabian Topollaj për të cilin nuk ka autorizim

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.09.03.2023*

nga kryetari i partisë. Në këto kushte i kërkoj Komisionerit kthimin për plotësimin e dokumentacionit të kësaj partie.

**Z. I. Celibashi:** Po zoti Fabian.

**Z. F. Topollaj, përfaqësues i PBD-së:** Faleminderit i nderuar zoti Komisioner! Në fakt unë nuk do të zgjatem fare sepse vendimmarrja dhe arsyetimi juaj është shumë i qartë për rastet paraardhëse. Në gjykimin tim neni 64 i Kodit Zgjedhor është shumë i qartë. Ai kërkon vërtetimin e regjistrimit në Gjykatë të partisë politike për të vërtetuar vetëm personalitetin juridik të subjektit. Vërtetimi i gjykatës nuk shpreh asnjë element tjetër, përveçse nëse subjekti është apo jo me personalitet të plotë dhe mund të kryejë veprime. Kjo është arsyeja që neni 64 në vijimësi kërkon në mënyrë të ndarë që partia të deklarojë emrin e saj zyrtar, kryetarin e partisë dhe me rradhë sepse mund të ndodhë që të ketë një mospërputhje midis regjistrimit dhe vendimmarrjes që është marrë ndërkohë. Nëse në mënyrë automatike KQZ-ja pasqyron të dhënat e vërtetimit të gjykatës, atëherë pyetja është përse ligji i kërkon këto të dhëna edhe njëherë nga e para? Emrin e kryetarit apo emrin e partisë. Është më e qartë në rastin e emrit të partisë sesa në rastin e emrit të kryetarit. Unë mendoj se i kërkon nga e para sepse ka parasysh që mund të jemi në një situatë, që pavarësisht se në regjistër emri i partisë është ende emri i vjetër, partia e ka ndryshuar këtë emër dhe nuk jemi në rastin që ka një konflikt, siç ishte rasti i Partisë Demokratike që kanë konflikt se kush është kryetari. Jemi në rastin që të gjithë palët brenda partisë janë të qarta që emri ka ndryshuar. Edhe në rastin e kryetarit, kryetari ka ndryshuar. Kjo është arsyeja që ne kërkesën e Bindjes Demokratike e kemi bërë me të dyja firmat, pra edhe të zotit Patozi që figuron në regjistër, por edhe të kryetarit të ri. Sikurse dhe çështja e emrit, kështu që në

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.09.03.2023*

gjykimin tim kërkesat nuk kanë asnjë mangësi. Subjekti politik duhet të regjistrohet, sipas të dhënave që vet partia ka deklaruar, siç e kërkon Kodi Zgjedhor dhe që nuk kundërshtohet nga askush. Ju vë në vëmendje se neni 35 i kushtetutës parashikon mundësinë e individit për të mbrojtur dhe korrigjuar të dhënat e tij personale. Do të thotë që ka mundësinë që ti korrigjojë këto të dhëna personale dhe ne jemi në rastin tipik. Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar ka ndryshuar të dhënat e saj personale, ka ndryshuar emrin dhe do që ta korrigjojë këtë, që ti paraqitet të tjerëve me emrin e ri. Kjo është një e drejtë që buron nga Kushtetuta dhe unë mendoj që duhet të regjistrohet si parti pas kësaj kërke, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit juve! Atëherë, shkurt vlerësoj që edhe në rastin tuaj dokumentacioni nuk është i plotë dhe në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe të ligjit për partitë politike. Personaliteti juridik i një subjekti juridik dhe në rastin konkret i një partie politike është një element, një e dhënë që ka disa komponent. Ka emrin, organin e tij drejtues dhe shumë elemente të tjerë. Në rastin e partisë politike ka një listë të të dhënave që e identifikonë atë si subjekt juridik dhe si parti politike nga të tretë, të tjerë. Për sa kohë këto nuk janë të qarta dhe qatësia vjen nga vërtetimi i gjykatës, KQZ-ja nuk mundet të disponojë. Çështja e emrit është gjithashtu është një çështje e rëndësishme. Mundet, siç thashë nuk është ky rasti sikurse për LZHK-në po e thoj, që ai emër të jetë i tillë që të refuzohet nga gjykata. Nuk e vendosim ne, e vendos gjykata. Për më tepër në rastin tuaj edhe deklarata e kryetarit të partisë do të duhet të nënshkruhet personalisht nga kryetari i partisë. Për çështjet e tjera mund të ketë diskutime. Për ato çfarë thamë, po ju japim edhe juve 24 orë për të plotësuar dokumentacionin, faleminderit.

**Vendimi nr. 155**

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.09.03.2023*

09.03.2023  
Ora 11:39

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Lëvizja Bashkë”,  
për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore  
të datës 14 Maj 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve           **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:   **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,  
Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike:**                                   **Partia Lëvizja Bashkë (A. Qori)**
- **Të tjerë:**   **KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me shqyrtimin e kërkesës së Partisë Lëvizja Bashkë.

**Z. Y. Merkaj:** Partia Lëvizja Bashkë ka dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për tu regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të parashikuar në nenin 64, pika 1 të Kodit Zgjedhor. Neni 64, pika 2, parashikon se partia për tu regjistruar si subjekti zgjedhor duhet të paraqesë një vërtetim që vërteton që partia është e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pas verifikimeve konstatohet se kërkuesi nuk e ka depozituar vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe për këtë motiv dokumentacioni i paraqitur nuk është në përputhje me kriterin e përcaktuar në nenin 64, pika 2 të Kodit

**Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.09.03.2023*

Zgjedhor. Për këto arsye i propozojmë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të mos e regjistrojë si subjekt zgjedhor partinë politike “Lëvizja Bashkë” në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Ju faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Falemnderit! Atëherë kemi përfaqësuesin e Partisë Lëvizja Bashkë, zotin Arlind Qori për të paraqitur kërkesën për regjistrimin e partisë në KQZ si subjekt zgjedhor, në zgjedhjet e 14 Majit.

**Z. A. Qori, përfaqësues i Partisë Lëvizja Bashkë:** Në interpretimin tone ne e kemi dokumentacionin sipas ligjit. Neni 64, pika 1 nuk specifikon llojin e vërtetimit apo llojin e...nëse vendimi duhet të jetë i formës së prerë apo jo. Nga ana tjetër nëse do të kërkohej vendim i formës së prerë, atëherë çdo partie tjetër ose çdo personi me qëllime destruktive ose antidemokratike do ti lejohej që të apelonte brenda 15 ditëve regjistrimin e një partie dhe për pasojë mund ta vononte me muaj ose me vite regjistrimin e kësaj partie në Gjykatën e Tiranës. Nga ana tjetër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në vitin 2019 ka marrë një vendim për Bindjen Demokratike që e ka regjistruar në zgjedhje, ndonëse Bindja Demokratike Brenda afateve nuk ka depozituar as vendimin e gjykatës. Ne e kemi depozituar vendimin e gjykatës në kohën e duhur. Nga ana tjetër ne e kemi dorëzuar në datën 9 janar firmat dhe gjithë dokumentacionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës për njohjen e partisë. Gjykata do të duhej të ishte shprehur në datën 9 shkurt. Gjykata është shprehur në datën 2 mars. Gjykata e ka shkelur ligjin me të dyja këmbët. Për mendimin tonë roli i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk është të lajë duart si Ponc Pilati, por të ndreqë një paligjshmëri që më herët e ka bërë Gjykata e Tiranës. Për të gjitha këto arsye une do të kërkoja regjistrimin e menjëhershëm të “Lëvizjes Bashkë” si parti politike, përndryshe ky do të ishte një precedent shumë i

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.09.03.2023*

rrezikshëm për demokracinë në Shqipëri, për pluralizmin edhe për faktin se në shkelje të ligjit një gjykatë dhe pastaj një komision qendror zgjedhjesh mund të pengojë 3500 qytetarëve në rastin tonë që të themelojnë një parti edhe të marrin pjesë në zgjedhjet lokale apo qendrore. Ju faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit zoti Arlind! Atëherë, në lidhje me kërkesën tuaj, pjesërisht qendron i njëjti arsyetim. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendos mbi regjistrimin e një partie politike bazuar në një dokumentacion zyrtar, të prodhuar nga një institucion i tretë, i cili nuk është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, por në rastin konkret është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Është Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë e cila mban edhe regjistrin e partive politike dhe mbi emrin e partisë, mbi emrin e kryetarit të partisë dhe më së pari mbi faktin që partia politike është e regjistruar, dokumenti i vetëm i cili e tregon këtë në vlerësimin tim është Ekstrakti i Regjistrimit të Partive Politike. Është e qartë që partia politike “Lëvizja Bashkë” është regjistruar ose është miratuar kërkesa për regjistrim, por ligji për partitë politike kërkon që krahas miratimit të bëhet edhe regjistrimi në regjistër. Regjistrimi në regjistër nuk është bërë akoma dhe jo pa arsye. Është me arsye dhe me shkak ligjor pasi do të duhet që regjistri i partive politike të presi marrjen në formë të prerë të vendimit për regjistrimin e partisë politike. Në nenin 18 nëse nuk gaboj, të ligjit për partitë politike është e përcaktuar qartë që kundër vendimit të regjistrimit ose të mosregjistrimit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit brenda 15 ditëve. Do të thotë që vendimi për regjistrimin e një partie politike e marrë nga Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë është një vendim i ankimueshëm. Jam i bindur, të themi, që nuk ka asnjë arsye në vlerësimin tim, po në fund të fundit është gjykata dhe gjykata vendos si do e çmojë, që ky vendim do të hyjë në fuqi. Jam i sigurtë që më së pari nuk do të këtë ankim ndaj këtij vendimi, por do të duhet

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.09.03.2023*

që ti qendrojmë strikt interpretimit formal të ligjit që në këtë rast është substancë. Pyetja që kam unë për ju është, keni ndonjë dokument tjetër të cilin juve mund ta prezantoni, me qëllim që t'ju jepja një afat për ta sjellë apo jo?

**Z. A. Qori, përfaqësues i Partisë Lëvizja Bashkë:** Ne kemi vendimin e gjykatësit të datës 2 mars.

**Z. I. Celibashi:** Atë e kemi.

**Z. A. Qori, përfaqësues i Partisë Lëvizja Bashkë:** Ne nuk mund t'i imponojmë gjykatës...Ne nuk kishim fuqi ti impononim gjykatës të zbatojë ligjin, që do të thotë të merrte vendim në datën 9, e jo më tani ti imponojmë gjykatës që të mos presë 15 ditëshin. Mirëpo unë përsëri po ngul këmbë që duke interpretuar ligjin gjerësisht dhe me frymën e tij, jo vetëm me germën, prandaj dhe në juridik ka dhe lëndë të filozofisë së ligjit dhe të filozofisë të së drejtës. Ligji nuk flet vetë, ligj nuk është robot, ligji interpretohet. Ju, institucioni juaj në vitin 2019 ka bërë një interpretim të ligjit për Bindjen Demokratike që ka qenë në kushte shumë të pafavorshme të themi krahasuar me ne. Ne në datën 6 mars kemi depozituar vendimin e gjykatësit. Siç e thatë edhe ju, ky vendim mund të apelohej ose mund të ankimohet, mirëpo nuk ka asnjë arsye sepse këtu nuk ka palë të ankimojnë. Nga ana tjetër, nëqoftëse do të marrim për standart ankimit e mundshme dhe pastaj muajt apo vitet e tëra që do i duheshin një partie për të kaluar të gjitha fazat e ankimit atëherë praktikisht çdo partie politike do të mund ti pengojë pjesëmarrja në zgjedhje sepse rivalët e vet politik, do të mund të çonin një kërkesë në gjykatë dhe kështu kurrë një partie të re politike nuk do i jepej mundësia për të marrë pjesë në zgjedhje. Kjo për mendimin tim do të ishte një lloj shkelje të themi

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.09.03.2023*

të barazisë ligjore të shtetasve, shkelje e të drejtës së shtetasve për tu organizuar në parti politike. Për të gjitha këto arsye kërkesa jonë është që edhe në bazë të frymës së ligjit, edhe në bazë të precedentit tuaj si institucion jo timit si person , ju të mos vlerësoni me dy standarte. Edhe në qoftë se do të vlerësonit me dy standarte, do të duhej që standarti i dytë të ishte me përfshirës, më demokratik dhe jo më diskriminues. Mirëpo unë mendoj se nuk duhet vlerësuar me dy standarte. Ju duhet ti qendroni konsekuent linjës suaj institucionale dhe ta miratoni kërkesën e Lëvizjes Bashkë. Një vendim negativ i juaji do të thotë sot me shumë mundësi të përjashtosh Lëvizjen Bashkë nga pjesëmarrja në zgjedhjet lokale të datës 14 Maj. Nëqoftëse një partie të re, e cila të gjithë dokumentacionin e ka dorëzuar në kohë, e cila është viktimë e një paligjshmërie të konstatueshme kollaj nga kushdo që di të lexojë një paragraf të ligjit, ose nje partie të tillë i pamundësohet pjesëmarrja në zgjedhje, unë besoj se kjo është një njollë turpi për shtetin shqiptar dhe për institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! E kuptoj dhe e mirëkuptoj shumë mirë narrativën tuaj edhe emocionale veçse logjike po se po, por duhet të sjell në vëmendje që institucioni i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk është institucioni i cili korrekton, aq më shumë akoma vendimet e gjykatave apo dhe në tërësi sjelljen e gjykatave. Unë jam plotësisht dakord me ju që në kushtet kur kërkesa juaj për regjistrimin e partisë politike është depozituar në datën 9 janar, do të duhej që gjykata të kishte vendosur brenda 30 ditëve. Kjo është e shkruar kaq qartë në ligj saqë nuk ka vend për ekuivok, por këtë nuk e rregullojmë dot në mënyrë kategorike.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.09.03.2023*

**Z. A. Qori, përfaqësues i Partisë Lëvizja Bashkë:** Më falni, po precedenti i vitit 2019?

**Z. I. Celibashi:** Do të vazhdoja edhe me atë. Lidhur me precedentin e vitit 2019, do ju sjell në vëmendje që ka edhe një precedent tjetër të kundërt me atë të vitit 2019. Në vitin 2015, ku në të njëjtat kushte si Bindja dhe ju, një parti politike nuk është regjistruar nga KQZ, dhe nga e njejta KQZ. Mund ta gjeni.

**Z. A. Qori, përfaqësues i Partisë Lëvizja Bashkë:** Atëherë është rregull, standart i dyfishtë i bie, për institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Z. I. Celibashi:** Sot do të kuptoni se si duhet të jetë standarti i vërtetë.


**Z. A. Qori, përfaqësues i Partisë Lëvizja Bashkë:** Do e kuptojmë në kurriz të demokracisë.

**Z. I. Celibashi:** Keq më vjen. Jam dakord me narrativën tuaj, pjesën tjetër të narrativës suaj, arsyetimin tuaj. Është e shëndetshme për demokracinë që shoqëria dhe ambjenti politik të jetë sa më pluralist, por nuk e ka këtë atribut KQZ-ja , me gjithë dëshirën e Komisionerit. Atëherë kuptova që nuk kemi ndonjë dokumentacion tjetër për të paraqitur.

**Përfaqësuese e Partisë Lëvizja Bashkë :** Zoti Komisioner a mund ta marr pak fjalën të lutem?

**Z. I. Celibashi:** Po.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.09.03.2023*

***Përfaqësuese e Partisë Lëvizja Bashkë*** : Faleminderit! Nuk e vë në diskutim që ju e keni shqyrtuar dhe e keni parë shkurtim vendimin që ne e kemi dorëzuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilën paraqitej numri i vendimit të seancës kur është marrë vendimi për regjistrimin e Lëvizjes Bashkë si edhe data kur është marrë ky vendim, që është data 02.03.2023. Në bazë të atij shkurtim vendimi është vendosur që: “ 1. Është pranuar kërkesa e Lëvizjes Bashkë; 2. Është regjistruar si person juridik i Partisë Lëvizja Bashkë në regjistrin e partive politike pranë Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Dhe ajo çfarë është shumë e rëndësishme është që ky shkurtim vendimi ose në bazë të seancës që është bërë në datën 02.03.2023 udhëzohet dhe urdhërohet zyra e regjistrit të partive politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të bëjë regjistrimin e Partisë Lëvizja Bashkë. Në bazë të nenit 64 të Kodit Zgjedhor ne automatikisht e kemi këtë dokument, i cila vërteton që Lëvizja bashkë është regjistruar në regjistrin e partive politike në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për atë kohë sa ky vendim nuk është apeluar dhe ne kemi dorëzuar këtë dokumentacion, brenda afatit kohor të përcaktuar nga KQZ-ja, automatikisht shkelet Kodi Zgjedhor. Nuk thuhet në asnjë moment në Kodin Zgjedhor që duhet vendimi i formës së prerë, madje thuhet se duhet vërtetim që Lëvizja Bashkë ose çdo parti politike është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk thotë në ndonjë gjykatë tjetër, faleminderit.

***Z. I. Celibashi:*** Faleminderit! Nuk do të ripërsëris çfarë thashë. Kuptova që nuk keni dokumentacion tjetër për të paraqitur nga ana juaj në lidhje me këtë kërkesë.

***Z. A. Qori, përfaqësues i Partisë Lëvizja Bashkë*** : Nuk jemi magjistarë.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.09.03.2023*

**Z. I. Celibashi:** E kuptoj, faleminderit! Atëherë unë vlerësoj që nuk jemi në kushtet për ta regjistruar Partinë Lëvizja Bashkë si subjekt zgjedhor për zgjedhjet, për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Kundër këtij vendimi keni të drejtën e ankimit në KAS brenda 3 ditëve nga dita e sotme, faleminderit.

**Vendimi nr. 157**

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.09.03.2023*

09.03.2023  
Ora 11:52

**RENDI I DITËS**

Projektvedndim “Për një shtesë në vendimin nr. 79, datë 01.03.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për akreditimin e vëzhguesve afatgjatë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, për vëzhgimin e zgjedhjeve, për organet e geverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”.

**PJESËMARRJA :**

**KQZ**

**1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Z. Ilirjan Celibashi**

**2. Staf i KQZ:**

**Z. Y. Merkaj, Znj:M. Koja,**

**P. Doçaj**

**Parti Politike:**

**PDSH, Bindja Demokratike, Partia**

**e Lirisë, Lëvizja Bashkë, LZHK**

**OJQ:**

**KRIIK, Përfaqësues nga Shoqëria  
Civile**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, regjistrimin e vëzhguesve.

**Z. Y. Merkaj:** Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka paraqitur kërkesën për akreditimin e dy vëzhguesve afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Me vendimin nr. 7, datë 01.03.2023 Komisioneri ka akredituar 25 vëzhgues afatgjatë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit. Në kërkesën e paraqitur në datën 07.03.2023 është kërkuar edhe shtesa për dy vëzhgues afatgjatë. Kërkesa e paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe i propozohet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që të bëhet miratimi dhe akreditimi i këtyre dy vëzhguesve, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.09.03.2023*

**Z. I. Celibashi:** Mirë atëherë e miratojmë kërkesën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit për shtesën në listën e vëzhguesve për zgjedhjet e 14 majit 2023. Faleminderit, seanca mbyllet!

**Vendimi nr. 159**

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*

